

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e bukurisë. Grabitje prej dhjetëra mijëra eurosh
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/foto-fiksimi-i-pazakonte-i-hajduteve-ne-sallonet-e-bukuri-se-prej-dhje-i103729
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 18:57:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 18:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7d99aceb03ede386bd9a81006429634d8c5c548179380fcd87032da4419d438d
TEKSTI	f20e83adbaadbbe612f2a10cf8aaa38e0060e743654119e810a5666f28d850c8
PAMJA	621ebd88518cfcadc52693225b2318f7159e6220844152d3c1a2c948e5aa2c38

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a728e22dcb61fa80c520ab11d01548853ac12d56e464b9fe3d460d1495b3e988
E MËPARSHMJA	c202cb5795967a4bbd1c7b00e2878e9ff1b8db7b222d3e2bd81094044b393602
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a728e22dcb61fa80c520ab11d01548853ac12d56e464b9fe3d460d1495b3e988>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

 [SYRI LIVE](#)



Flash: [nga Franca, që hasën nga policia](#) ■ [protestuesit marshojnë](#) ■ [doreneqjen Rama në burg. Ata pritet të](#) ■ [mobilizim afatgjatë](#) ■ [çdo mbrëmje në Tiranë dhe atëdit](#) ■ [orësh në Mal të](#) ■ [udhëton nga Anglia drejt](#) ■ [Greqisë, e personave të arrestuar](#) ■ [shqiptar që ra në](#)

 [BOTA](#)

FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e bukurisë. Grabitje prej dhjetëra mijëra eurosh

Piranjat Përditësimi i fundit 11 Shtator 2026, 20:41



 FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e

Një formë e pazakontë krimi po zë vend qendror në Melburn, pasi hajdutët kanë synuar sallonet e flokëve, duke vjedhur paruke luksoze, zgjatje dhe gërsheta flokësh me vlerë mijëra dollarë.

Vetëm në tre muajt e fundit, ka pasur disa vjedhje me thyerje në sallonet e flokëve në zonën e madhe të Melburnit, dy prej të cilave ndodhën në të njëjtën natë, më 9 shtator, duke shkaktuar shqetësim midis pronarëve të bizneseve të vogla.

Autorët hynë me forcë në dyqanin "Carla Lawson Hair Extensions", dhe në Frika Hair, me një diferencë prej rreth gjysmë ore, rreth orës 3 të mëngjesit.

Pamjet e kamerave të sigurisë tregojnë një burrë që hyn në dyqanin "Carla Lawson Hair Extensions", duke përdorur hyrjen e dyqanit dhe duke mbajtur një elektrik dore dhe një kovë.

Autori i kimit u dretua menjëherë drejt një rafti ku ishin varur dhjetëra ekstejshen. Lëvizja e tij aktivizoi alarmin e dyqanit, por kjo nuk e dekurajoi. Ai vazhdoi të kontrollonte dollapët dhe më pas filloi të merrte edhe disa kapëse flokësh.

 FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e

Rreth dy minuta më vonë, një burrë i dytë hyri në dyqan dhe e ndihmoi të transferonte dhjetëra paruke nga një çantë në një çantë të madhe.

Vjedhja zgjati rreth tre minuta. Dy burrat u larguan me nxitim, duke lënë disa prej sendeve të vjedhura në dyscheme. Përveç produkteve të flokëve, Policia e Viktorias tha se autorët morën edhe dy laptopë.

Dëmi mbi 50 mijë dollarë

Themeluesi i "Carla Lawson Hair Extensions", Stuart Lawson, tha se një "vlerësim i kujdesshëm" e ka përlogaritur dëmin e shkakuar nga vjedhja në më shumë se 50 mijë dollarë austrianë.

Ai shpjegoi se shumica e produkteve të vjedhura ishin porosi të veçanta, të destinuara për klientë që kishin rezervuar takime gjatë javëve dhe muajve në vijim.

Biznesi u detyrua të kontaktonte klientët e prekur dhe të ricaktonte takimet e tyre, ndërsa stafi nisi të evidentonte produktet e vjedhura.

Në fakt, kjo është hera e dytë që ky sallon bukurie bëhet objekt i një vjedhjeje. Një incident i ngjashëm kishte ndodhur më shumë se një vit më parë.

 FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e

Përveç produkteve të flokëve, në shënjestrë të hajdutëve janë edhe mjetet profesionale. Disa sete gërshërësh mund të kushtojnë deri në 3,000 dollarë, ndërsa tharëset e flokëve dhe pajisjet elektrike të nivelit të lartë mund të arrijnë rreth 1,000 dollarë.

Për këtë arsye, disa sallone bukurie kanë kufizuar ekspozimin e produkteve të shtrënjta në vitrina dhe po i ruajnë ato në ambiente ku vetëm punonjësit kanë akses.

Presidentja kombëtare e organizatës "Hair and Beauty Australia", Maureen Harding, shprehu shqetësimin se në disa raste autorët mund të kenë marrë edhe "porosi" për produkte specifike, me qëllim rishitjen e tyre.

Harding tha se edhe ajo vetë ka përjetuar incidente të ngjashme gjatë 46 viteve të saj në industri, ku hajdutët kanë marrë tharëse flokësh dhe gërshërë profesionale me vlerë të lartë.

Lawson tha se masat e sigurisë ishin rritur pas vjedhjes

së mëparshme dhe biznesi tani ishte në bisedime me pronarin e pronës për të siguruar më tej ambientet. Megjithatë, dëmi financiar nuk ishte i kufizuar vetëm në produktet e vjedhura. Disa klientë kanë kërkuar rimbursimin e depozitave të tyre pasi porositë e tyre ishin për raste të veçanta, siç janë dasmat, dhe biznesi nuk mund t'i përmbushë më datat e rena dakord.

 FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e

Policia e Viktorias beson se të njëjtët autorë mund të kenë shkuar më pas në "Frika Hair", në Melburnin Jugor, rreth dhjetë minuta larg me makinë. Më shumë paruke flokësh, mjete dhe produkte flokësh dyshohet se u vodhën nga salloni i dytë, si dhe para në dorë.

Incidenti është pjesë e një serie vjedhjesh në sallone flokësh në muajt e fundit.

Drejtoresha ekzekutive e Këshillit Australian të Flokëve, Fiona Beames, tha se shumë pronarë biznesesh të vogla dhe profesionistë mendonin se ishte "vetëm çështje kohe" para se edhe ata të beheshin shënjestrë.

Ajo shpjegoi se kriminelët po kërkonin artikuj me vlerë të lartë që mund të rishiten në tregun e zi.

Zgjatjet dhe endjet e flokëve ishin veçanërisht tërheqëse për hajdutët sepse, varësisht nga cilësia e tyre, një pako mund të kushtonte midis 500 dhe 2,000 dollarëve, ndërsa janë të lehta dhe mund të mbahen lehtësisht në një çantë.

 FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e

Përveç produkteve të flokëve, në shënjestrë të hajdutëve janë edhe mjetet profesionale. Disa sete gërshërësh mund të kushtojnë deri në 3,000 dollarë, ndërsa tharëset e flokëve dhe pajisjet elektrike të nivelit të lartë mund të arrijnë rreth 1,000 dollarë.

Për këtë arsye, disa sallone bukurie kanë kufizuar ekspozimin e produkteve të shtrënjta në vitrina dhe po i ruajnë ato në ambiente ku vetëm punonjësit kanë akses.


 FOTO/ Fiksimi i pazakontë i hajdutëve në sallonet e

Presidentja kombëtare e organizatës Hair and Beauty Australia, Maureen Harding, shprehu shqetësimin se në disa raste autorët mund të kenë marrë edhe “porosi” për produkte specifike, me qëllim rishitjen e tyre.

Sipas saj, këto incidente nuk janë diçka e re, pasi vjedhjet në sallonet e flokëve janë regjistruar në Melburn prej vitesh.

Harding tha se edhe ajo vetë ka përrjetuar incidente të ngjashme gjatë 46 viteve të saj në industri, ku hajdutët kanë marrë tharëse flokësh dhe gërrshërë profesionale me vlerë të lartë. **/PiranjatNews/**

Galeria fotografike ()





Artikuj te sugjeruar

BOTA 11 Shtator20:17

[Dy përballje me F-16 të armatosur mbi Egje](#)

Ankaraja po përshkallëzon provokimet e saj në Detin Egje. Të premten, Forcat Ajrore Turke kryen 10 shkelje të hapësirës ajror...

BOTA 11 Shtator20:10

[Mohammed bin Salman i kërkoi Trumpit të godasë Houthit, SHBA refuzoi përfshirjen direkte](#)

Princi i Kurorës së Arabisë Saudite, Mohammed bin Salman, i kërkoi dy herë presidentit amerikan Donald Trump që Shtetet e Bashkuar...

BOTA 11 Shtator19:55

[Trump nga Pentagoni: Irani nuk do të ketë kurrë, kurrë një armë bërthamore](#)

Donald Trump ka mbajtur një fjalim në përkujtimin e 11 shtatorit në Pentagon këtë pasdite. Presidenti amerikan i përdori kom...

BOTA 11 Shtator19:26

[Meloni përshëndet suksesin e partisë së ekstremit të djathtë Alternativa për Gjermaninë](#)

Partia e ekstremit të djathtë Alternativa për Gjermaninë (AfD) po bëhet më e fortë sepse "Koalicioni i Madh" n&eu...

BOTA 11 Shtator18:55

[Autobusi me turistë del nga rruga dhe përmbysët/ 5 të vdekur dhe 40 të plagosur](#)

Pesë persona kanë humbur jetën dhe 40 të tjerë janë plagosur pas një aksidenti të rëndë trafiku të enjten...

BOTA 11 Shtator18:31

[Fjalët e para të babait të Giorgos Mazonakis pas vdekjes së tij: Kush do ta sjellë fëmijën tim përsëri tek unë?](#)

Me zemër të thyer, babai i tij foli për herë të parë pas humbjes së Giorgos Mazonakis. Manolis Mazonakis ...

BOTA 11 Shtator18:04

[Funerali i 'papranueshëm' i Mlladiç/ Kroacia paralajmëron Serbinë për tërheqjen e mbështetjes për në BE](#)

Kryetari i parlamentit të Kroacisë e paralajmëroi të premten Serbinë se nuk mund të mbështetet në mbështetjen e Zag...

BOTA 11 Shtator18:03

[Sekretari amerikan i Luftës betohet: Do ta përfundojmë betejën me Iranin](#)

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, është deklaruar për luftën e Iranit, gjatë ceremonisë përkujtimore të 11 s...

BOTA 11 Shtator17:56

[11 shtatori/ Trump: Nuk do të harrohet kurrë! 25 vitet që pasuan treguan fuqinë e Amerikës për të triumfuar dhe fituar](#)

Presidenti Donald Trump deklaroi të premten në Pentagon se fryma e fuqishme amerikane, e cila ka qëndruar e fortë gjatë 25 viteve q&eum...

BOTA 11 Shtator16:41

[Nga president në kandidat për kryeministër, Aleksandër Vuçiç zbulon kur do të japë dorëheqjen](#)

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, deklaroi se do të japë dorëheqjen nga posti më 25 ose 26 shtator, duke thënë...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 11 Shtator

[**EMRAT/ Vrasja e Ferdinand Hotit në Itali, kush ...**](#)

Hetimet për vrasjen e Ferdinand Hotit, 35 vjeç, shqiptarit me banim në Mirano, po përqendrohen në botën e trafikut të drog&...

BOTA 11 Shtator

[**“Përbindëshi i Malanit”/ Droni sekret kinez me ...**](#)

Një dron sekret kinez, i njohur si WZ-X ose “Përbindëshi i Malanit”, ka tërhequr vëmendjen e ekspertëve ushtarak&eum...

SHOWBIZ 11 Shtator

[**VIDEO/ Dalin pamjet, ky është i dashuri i Franç...**](#)

Gazetari Elton Tozaj ka rikthyer sërish në vëmendje jetën private të personazheve të showbiz-it. Këtë herë, n&eum...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cilevio!



Reagon Cilevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjestit!



7 September 2026



Pamje apokaliptike nga Puka!



7 September 2026



Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.



Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.



Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.



5 September 2026



5 September 2026



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.